

HYRJE:

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Plani i Reagimit Kombëtar pika III (Rolet dhe përgjegjësitë e komunave), Rregulloren nr. 28/2012 për Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit si dhe Planit vjetor i punës.

Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike, konkretisht Sektori për Siguri dhe Emergjencë, ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e objekteve që paraqesin rrezik për qytetarë si në vijim :

1. Deçan – Kulla e familjes Dobrunaj,
2. Muret në rrugën “Mehmet Uka”
3. Kulla e Binakajve- Beleg
4. Muret – Carrabreg i Epërm
5. Muri në rrugën “Lavdim Likaj” – Carrabreg i Poshëm
6. Muri në lagjen “Ledinat”
7. Kulla e Isuf Asllanaj – Pozhar
8. Kulla e Shaqir Berishës – Prapaqan
9. Kullat në fshatin Pobergjë
10. Kulla në fshatin Baballoq
11. Kulla e Sadik Çekaj,
12. Objekti i vjetër i shkollës dhe Objekti i Ofiqarisë – Irzniq

Qëllimi i Vlerësimit

Në këtë plan është bërë identifikimi i objekteve që paraqesin rrezik shembje në gjithë territorin e Komunës së Deçanit, gjithashtu është bërë vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë së tyre si dhe masat që duhet të merren për zvogëlimin e rrezikut, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga këto objekte, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit. Qëllimi i këtij plani është edhe krijimi i prioriteteve për një koordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e ndodhjes së ndonjë fatkeqësie nga këto objekte.

Objektivat e Vlerësimit:

1. Kuptimi i rrezikut
2. Identifikimi i rrezikut
3. Analiza e rrezikut
4. Vlerësimi i rrezikut;
5. Masat për parandalimin e fatkeqësive
6. Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve
7. Mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale
8. Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit



Kosova, sidomos Deçani pas lufte ishte i shkatërruar pothuajse tërësisht, kishte shtëpi, shkolla, kulla, objekte fetare e kulturore tërësisht të shkatërruara.

Krijimi i institucioneve qeveritare, ndihmat nga bashkatdhetarët si dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare mundësuan rindërtimet ku u ndërtuan shumë rrugë, shkolla, shtëpi dhe objekte tjera. Megjithatë gjendja e vështirë ekonomike pas lufte ka bërë që shenjat e luftës të mos shuhen krejt dhe pasojat të ndihen e të shihen edhe sot e kësaj dite.

Objekte të vjetra, të pabanuara, të braktisura dhe të shkatërruara ndodhen në vende të caktuara dhe rrezikojnë dita ditës të shemben duke i rrezikuar seriozisht qytetarët që kalojnë andej pari, por edhe automjetet të cilët kalojnë afër tyre. Poashtu këto objekte krijohen me kohe edhe si deponi e mbeturinave ilegale, përdorimi i tyre nga njerëz të papërgjegjshëm si narkomanë, përdoret si strehë për qentë endacake, gjarpërinjtë etj.

Mungesa e kujdesit ndër vite i ka degraduar këto objekte në pa kthim dhe si të tilla janë të rrezikshëm për qytetarët.

Më poshtë po i paraqesim objektet me rrezikshmëri të lartë në Komunën tonë:

1. Kulla e Sahit Dobrunaj- Deçan



Koordinatat: 42°32'13"N 20°17'27"E 605 m

Kulla e cila gjendet në rrugën kryesore "Dëshmorët e Kombit" ka pësuar dëmtime të mëdha dhe paraqet rrezik të madh për banorët që jetojnë afër saj. Muret e saj të larta janë të paqëndrueshme dhe rrezikojnë të shemben duke i rrezikuar kalimtarët, shtëpitë që e rrethojnë si dhe makinat.

2. Kulla e Binakaj-ve në fshatin Beleg



Koordinatat: 42°32'13"N 20°18'46"E 573 m

Në rrugën kryesore "Sadri Vishaj" në fshatin Beleg ndodhet kulla e Familjes Binakaj, muret e së cilës janë mjaft të dëmtuara dhe rrezikojnë të shemben dita ditës duke i rrezikuar seriozisht kalimtarët të cilët kalojnë afër saj si dhe makinat e shumta që frekuentojnë këtë rrugë. Bashkangjitur me kullë është edhe muri mjaft i lartë i cili është i shkatërruar dhe rreziku i rënjes së gurëve nga të dy këto objekte paraqesin rrezik të madh.

3. Muret përgjatë rrugëve “Hysni Dautaj” dhe “Lataj”

Carrabreg i Epërm



Fig. 1- Muri I shtëpisë së Jashar Zekaj
Fig. 3 - Muri rrethues I Bekë Dautaj

Fig. 2 - Muri I shtëpisë së Shefqet Zekaj
Fig. 4 - Muri rrethues I Esat Lataj

Fig 1 Koordinatat: 42°31'35"N 20°17'31"E 594 m

Fig. 2 Koordinatat: 42°31'32"N 20°17'33"E 594 m

Fig 3 Koordinatat: 42°31'37"N 20°17'33"E 592 m

Fig. 4 Koordinatat: 42°31'37"N 20°17'32"E 593 m

Gjithë këto mure gjenden në fshatin Carrabreg i Epërm, janë të ndërtuar me material guri, vjetërsia dhe moskujdesi ndaj tyre ka bërë që këto mure të shkatërrohen dita ditës duke rrezikuar banorët, kalimtarët si dhe automjetet e shumta, pasi që të gjithë ndodhen bregut të rrugës.

4. Muri në rr. “Lavdim Likaj”



Koordinatat: 42°32'01"N 20°17'56"E 587 m

Muri në rr. “ Lavdim Likaj” afër kullës së Ramosajve është mjaft i shkatërruar. Pranë tij kalon trotuari dhe gurët që i bien rrezikojnë qytetarët e shumtë që frekuentojnë këtë rrugë.

5. Ledinat



Koordinatat: 42°30'55"N 20°19'22"E 542 m

Muri përgjatë rrugës “ Haki Balaj” në lagjen Ledinat, është i shkatërruar dhe paraqet rrezik për banorët, kalimtarët si dhe automjetet.

6. Prapaqan



Koordinatat: 42°33'05"N 20°19'56"E 548 m

Kulla e Shaqir Berishës në rrugën “Enver Berisha” në Prapaqan, ka filluar të shembet në një rën të saj (pjesa e majtë), pjesë e cila ndodhet bregut rrugës. Rënia e ndonjë guri, do paraqiste rrezik për kalimtarët si dhe makinat që kalojnë afër saj.

7. Kulla e Isuf Hadergjonaj



Koordinatat: 42°31'18"N 20°16'06"E 666 m

Ky objekt gjindet pranë rrugës “Hadergjonaj”. Fillimisht përdorej si kullë, pastaj pozllom (aneks shtëpie) dhe shitore. Tani është jashtë përdorimit dhe rrëshqitja e gurëve rrezikon këmbësorët, automjetet dhe kalimtarët e rastit.

8. Kulla e Haxhë Haxhaj



Koordinatat: 42°31'32"N 20°15'47"E 700 m

Kulla e cila gjendet në rrugën "Arif Vokshi" në Pobergjë është në gjendje shumë të keqe. Kulla ndodhet afër shtëpive të banimit dhe shembja e mureve të larta rrezikon seriozisht jetën e banorëve që jetojnë afër kullës.

Nga rrëshqitja e vazhdueshme e gurëve të kullës, brenda saj janë krijuar mbeturina të cilat kanë shërbyer për formimin e shumë gjallesave dhe zvarranikëve të shumtë.

9. Shtëpia e Shkelzen (Reshyt) Hadergjonaj



Koordinatat: 42°31'20"N 20°16'03"E 673 m

Shtëpia e vjetër dhe e shkatërruar nga lufta e familjes Hadergjonaj paraqet rrezik të shembet duke i rrezikuar banorët dhe automjetet që kalojnë afër saj.

10. Kulla në fshatin Baballoq



Koordinatat: 42°29'03"N 20°20'55"E 486 m

Kulla në hyrje të fshatit Baballoq, është pothuajse tërësisht e shkatërruar. Rënia e gurëve nga muret e larta të kullës rrezikojnë kalimtarët, banorët si dhe automjetet e shumta që kalojnë afër saj.

11. Kulla e Sadik Brahim Cekaj- Irzniq



Koordinatat: 42°31'14"N 20°20'46"E 526 m

Kulla e familjes Çekaj, e gjendet në rrugën “Blerim Dervishaj” ka mure të larta dhe rreziku nga rënja e ndonjë guri është mjaft i lartë, duke rrezikuar jetën e banorëve si dhe automjeteve që kalojnë afër saj pasi që kulla është skaj rrugës. Rrezik paraqet edhe për familjarët të cilëve u duhet kaluar skaj saj për të dal në rrugë.

12. Shkolla e vjetër dhe objekti i zyrës së gjendjes civile(Ofiqaria)-Irzniq



Fig.1 Shkolla e vjetër



Fig.2 Objekti në qendër të fshatit

Në fshatin Irzniq problematike mbeten edhe dy objektet e lartshënuar, të cilat janë jashtë funksionit. Për shkak të mbeturinave të shumta brenda dhe afër objekteve ka rrezik të madh për shëndetin e nxënësve dhe banorëve nga grumbullimi i qenve endacakë, zvarranikët dhe helmet toksike që mund të jenë në brendi të mbeturinave.

MASAT PREVENTIVE NGA OBJEKTET QË PARAQESIN RREZIK SHEMBJE NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

Me qëllim të parandalimit të krijimit të ndonjë situatë emergjente apo rasti tragjik duhet të ndërmerren këto masa preventive:

1. Shenjëzimi me tabelë njoftuese që paraqet rrezikun nga objekti
2. Përkufizimi i objekteve me rrethoja për parandalim të ndonjë fatkeqësie
3. Mirëmbajtja, riparimi i objektit
4. Ndërhyrja e përsëritshme në pjesët ku paraqiten rrezik
5. Rrënimi i objektit

REKOMANDIM

Të gjitha këto objekte që janë të rrezikuara nga shembja, e që disa nga to bëjnë pjesë në trashëgiminë kulturore- historike duhet të merren masa për renovimin e tyre, konservimin, ndërtimin apo largimin e tyre nga Institucionet përkatëse si : Instituti i Trashëgimisë Kulturore, Agjencionit për Menaxhimin e Komplekseve dhe Memorialeve të Kosovës, Organizata Ndërkombëtare që merren me ruajtjen e trashëgimisë kulturore si dhe institucioneve tjera lokale apo qendrore.